

P. nr.672/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit J. H. nga fsh. H, K-Gjakovë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP/II.nr.1220/18 të datës 24.09.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 25.03.2019, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu si dhe te akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **J. H.**, nga fsh. H, K- Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës M. e gjinisë Gj, data e lindjes ... në Gjakovë, ka te kryer shkollën fillore, i pa punë ,i gjendjes se dobët ekonomike ,shqiptar ,shtetas i R. Kosovës ,i pa martuar , me nr. ID ...

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

- **me datë 20.08.2018, rreth orës20:00h** ,në rrugën Gjakovë nga Gjakova në drejtim të fsh.H. në lagjen “...” përball rrugës afër kryqëzimit “...” , duke drejtuar automjetin “...” me targa ...-...-... , rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 41 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor Nr. 05/L-088,dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë ,në atë mënyrë që duke mos ja përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë, bën vozitje të pakujdesshme , duke tejkualuar një qerre kali pa e përfunduar tejkalimin , ngasësi i qerres merr veprim të pasigurte që të kthehet në të majtë për tu lidhur me rrugën “...” , i dyshuari me të vërejtur se qerrja po kthehet në të majtë në shiritin e tij të lëvizjes , duke mos reaguuar fare , me pjesën e parë frontale e ka goditur mbrapa qerren me pjesën e krahut të majtë dhe nga goditja pjesa e përparme e qerres shpëputet , ndërsa pjesa e pasme mbetet në pjesën e përparme të veturës së bashku me podin e qerres në krahun e majtë , ndërsa kali me pjesën e parë të qerres largohet rreth 11m largësi në të majtë të rrugës e që me këtë rast si pasojë e aksidentit ngasësi i qerres merr lëndime të lehta trupore , më për së afërmi të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.20.09.2018 të Dr. F. D.

**-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 ,neni 378 par. 6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4( katër ) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari Z. (M. )Z. nga Gjakova, lagjja Dardania Rr. “.... “, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej **71.10 euro** (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizës mjekë-ligjore) si dhe ne emër të paushallit

gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbaramit me dhunë.

**Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës Zyra Regjionale në Gjakovë .**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1220/18 të datës 24.09.2018, e ka akuzuar të akuzuarin J. H. nga fsh. H., K- Gjakovë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës , duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar me datë 25.03.2019, përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë, Prokurori Bajram Kryeziu, lexoi aktakuzën PP/II.nr.1220/18 të datës 24.09.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari J. H., gjatë shqyrtimit fillestar, lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, kërkojë faljen nga i dëmtuari për lëndimet e marra, po ashtu edhe nga vet ekspertiza e komunikacionit rezulton se ngasësi i qerres ka bere lëshime qe kanë kontribuar aksidentit të komunikacionit ,andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike , pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshme , si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Bajram Kryeziu , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorin juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale qe gjenden në shkresat e lendes, dhe se nga këto prova vërtetohet edhe gjendja faktike në aktakuzë dhe përmbushen të gjitha elemente të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari J. H. - **me datë 20.08.2018, rreth orës20:00h** ,në rrugën Gjakovë nga Gjakova në drejtim të fsh.H. në lagjen “...” përball rrugës afër kryqëzimit “...” , duke drejtuar automjetin “...” me targa ..-...-.. , rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 41 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor Nr. 05/L-088,dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë ,në atë mënyrë që duke mos ja përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë, bën vozitje të pakujdesshme , duke tejkaluar një qerre kali pa e përfunduar tejkalinimin , ngasësi i qerres merr veprim të pasigurve që të kthehet në të majtë për tu lidhur me rrugën “...” , i dyshuari me të vërejtur se qerrja po kthehet në të majtë në shiritin e tij të lëvizjes , duke mos reaguuar fare , me pjesën e parë frontale e ka goditur mbrapa qerren me pjesën e krahut të majtë dhe nga goditja pjesa e përparme e qerres shpëputet , ndërsa pjesa e pasme mbetet në pjesën e përparme të veturës së bashku me podin e qerres në krahun e majtë , ndërsa kali me pjesën e parë të qerres largohet rreth 11m largësi në të majtë të rrugës e që me këtë rast si pasojë e aksidentit ngasësi i qerres merr lëndime të lehta trupore , më për së afërmi të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.20.09.2018 të Dr. F. D.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar

provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh personalitetin e të akuzuarit, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, kërkim falja nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Në këtë drejtim Gjykata ka marr parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale përkatësisht shkaktimin e aksidentit i cili ka ardhur pjesërisht edhe me lëshimet e të dëmtuarit, i cili me lëshimet e tij si moskujdesi i duhur gjatë kthimit majtas dhe mos pajisja e qerres me drita në të dyja pjesët (parme dhe pasme) gjatë lëvizjes natën e kjo është shprehur qartë edhe në raportin ekspertizës së komunikacionit, të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatojë dispozitat e zbutjes se dënimit të parapara në nenin 73 të KPPK-së. Gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPPK-së, dhe se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.5672/18 më datë 25.03.2019**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.